

2021053766

LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT TË FINANCIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE

Neni 1

Në Ligjin e Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009, 47/11, 192/15, 209/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 244/19) pas nenit 9 shtohet nen i ri 9-a, siç vijon:

Neni 9-a

Të hyra nga tatimi mbi vlerën e shtuar për vitin 2021

Me përjashtim të nenit 9 paragrafi (2) të këtij ligji, të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar për vitin 2021 sigurohen në lartësi prej 4,5% nga mesatarja e tatimit mbi vlerën e shtuar të arkëtuar në tri vitet e fundit fiskale.“.

Neni 2

Dispozitat e nenit 9-a të këtij ligji, do të zbatohen në periudhën nga 1 janari 2021 deri më 31 dhjetor 2021.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.